



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primihero/Prodato Received/Delivered	01.09.2023	viti god year	
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sësia Kolicina Quantity
SRM/HM	5929/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.919/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Sabile Avdyli-zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.919/2023, të datës 05.07.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1; nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.919/2023, e datës 05.07.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, (*tutje ankuesja*), e punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 05.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të ndalesave në pagave lidhur me shtesat për vëllim të punës, me pretendimin se një ndalesë e tillë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat në Sektorin Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, kjo e fundit, me datë 13.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 5542/2023, të datës 04.08.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën A.nr.919/2023, për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5031/2023 të datës 05.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Vendimin Ref.02/Nr. 278 i datës 05.09.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësish dhe Tregtisë; Marrëveshjen për punën me vëllim të shtuar me numër protokollit 267-02, e datës 07.04.2023, lidhur për periudhën 07.04.2023 deri më datë 01.04.2024; E-maili i datës 04.07.2023 kërkesë për informatë nga Zyrtarja e lartë ekzekutive në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm për ankuesen; Kërkesë për ndalesën në pagë përmes e-mailit të datës 05.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 13.07.2023 bashkë me shkresat e lëndës; E-maili i datës 11.07.2023 dhe Akt Emërimi i datës 01.10.2018.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses është e palejuar, **sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësish dhe Tregtisë (tutje MINT), dhe se e njëjta sipas Aktit të Emërimit, të datës 01.10.2018, është emëruar në pozitën e punës “Zyrtare e Integriteteve Evropiane” në Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Me Vendimin Ref.02/Nr.278, të datës 05.09.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT, ankuesja është caktuar përkohësisht për kryerjen e detyrave në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa përmes Marrëveshjes me numër protokollit 267-02, të datës 07.04.2023, e lidhur në mes të Sekretarit të Përgjithshëm, përkatësisht me nenin 1 përcaktohet se qëllimi i marrëveshjes është përcaktimi i detyrave edhe përgjegjësi shtesë për ankuesen, e cila do të angazhohet për të punuar më vëllim të shtuar brenda orarit të rregullt të punës, kurse sipas nenit 5 të kësaj marrëveshje, parashihet se për punën më vëllim të shtuar, ankuesja si palë e marrëveshjes përfiton shtesë mujore në 20 % të pagës mujore, e të cilën shtesë ankuesja e kishte realizuar për dy muaj, mirëpo Thesari i Kosovës përmes e-mailit të datës 30.05.2023, kishte kërkuar edhe përgatitjen e formularëve për ndryshim dhe ndalesë në pagë për ankuesen, me sqarimin së shtesat për ankuesin janë dal gabim, ndalesë kjo që sipas ankueses është bërë në muajin korrik 2023.

Ankuesja në ankesën e saj të parashtruar në Këshill, pretendon që përveç detyrave sipas Aktit të Emërimit, e njëjta nga data 05.09.2022 ushtron edhe detyrat në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, me ç’rast si pasojë e këtij angazhim shtesë dhe volumi të madh të punëve, ka lidh marrëveshje për punën me vëllim shtesë më ZKA-në, e cila është zbatuar dy muaj, mirëpo që në muajin korrik nga banka është bërë ndalesa e shtesave për dy muaj, dhe së për këtë ndalesë nuk ka marr ndonjë arsyetim paraprak. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, ti kthehet ndalesa në pagë për muajin maj dhe qershor dhe të zbatohet Marrëveshja me numër protokollit 267-02, e datës 07.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës nuk ka gjetur së ankuesja ka parashtruar të organi i punësimit, kërkesë lidhur me ndalesën e shtesave për vëllim shtesë të punës dhe njohje të kompensimit të pagës për vëllim shtesë sipas marrëveshjes së datës

07.04.2023, kështu që në rrethanat e rastit konkret nuk kemi veprim apo mosveprim të organi të punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organi të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankuesja lidhur me kërkesat sikurse në ankesën e parashtruar në Këshill, fillimisht duhet të drejtohet të organi i punësimit dhe vetëm pas veprimit të organi të punësimit apo heshtjes administrative të organi në raport me kërkesën e ankuesit, e njëjta mund të parashtror ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke respektuar dispozitat ligjore të afatit për ankesë siç përcaktohet me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmërinë të ankesës, sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.919/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të MINT;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MINT dhe
- Arkivit të KPMSHC-së

